



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e dates 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 si dhe nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 12 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2024, të miratojë këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SHOQATËS SINDIKALE TE ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

I ipet pëlqimi Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare, në shumë prej 8000 €, (tetë mijë) euro Shoqatës Sindikale të pavarur e Administratës Komunale, sipas kërkesës së tyre të datës 14.03.2024, me qëllim të mbështetjes financiare për realizimin e vizitës dy ditore jashtë territorit të Republikës së Kosovës për të gjithë stafin punues të Administratës Komunale .

Neni 2

Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për Drejtoratin për Administratë për vitin 2024, kodi i programit 16303 fondi burimor 21/613/16303/200/00000/0133.

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Shoqata Sindikale e pavarur e Administratës Komunale i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Komunës me date 14.03.2024, me të cilën kanë kërkuar mbështetje financiare për realizimin e vizitës dy ditore jashtë territorit të Republikës së Kosovës për të gjithë të punësuarit në kuadër të Administratës Komunale e cila vizitë planifikohet të realizohet në muajin maj të këtij viti .

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të Kërkesës së lartëcekur në pajtim me dispozitën e nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019 për të mar Vendim për ndarjen e mjeteve kërkon nga Kuvendi dhënien e pëlqimit pasi është fjala për kërkesë që tejkalon shumën mbi 2000€ .

1Nr. 400/01-14784
Lipjan, më 16.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me Primitje:	14.03.2024	
Njësia Jednice	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-400/01-14689		



Për:	z. Imri Ahmeti-Kryetar I Komunës
Nga:	Albert Mustafa-Kryetari i Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale në Lipjan
Data:	14.03/2024
Lënda	Kërkesë

I nderuar, Kryetar

Kërkojmë nga ana e juaj që të na mbështesni brenda mundësive tuaja financiare të për realizimin e projektit të SHSPAK sipas të cilit kemi planifikuar si në vijim: Realizimin e një vizite dy ditore jashtë territorit të Republikës së Kosovës të cilin planifikoj ta realizojmë në muajin Majë të këtij viti.

Në këtë vazit planifikojmë të marrin pajës të gjithë të punësuarit në Administratën Komunale.

Për realizim e këtij projekti kostoja e përafërt mendohet të jetë 8000 euro.

Pasi që ne si SHPSAK nuk kemi mundësi nga mjete e grumbulluar nga anëtarësia ti mbulojmë këto shpenzimet kërkojmë nga ju që të na përkrahni në këtë iniciativa tonën e cila mendoj që do të jetë e dobishme për punëtorët e Administratës.

Ritheksojmë se mjetet e grumbulluar nga anëtarësia e sindikatë janë të pakta apo jo të mjaftueshme për realizim e kësaj vizite andaj kemi kërkuar koston që nuk mundemi ta mbulojmë me mjetet e anëtarësisë ta mbuloni me këtë shumë të mjeteve të kërkuara.

Mbesim me shpresë se kërkesa e jon do të aprovohet.

Plani financiar për realizimin e projekti: Vizitë dy ditore jashtë Republikës së Kosovës.

Aktivitetet	Shuma
Transporti	1100 euro
Akomodimi në Hotel	6900 euro
Gjithsejt	8000 euro